REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 313, Datë 26.10.2026

MBI

RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 15, DATË 27.08.2003 "PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "PROJEKSION ENERGJI" SH.A. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3184 prot., datë 26.10.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi rishikimin e vendimit të bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 15, datë 27.08.2003, "Për licencimin e shoqërisë "Projeksion Energji" sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike", i ndryshuar"*,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "Projeksion Energji" sh.a.

- Shoqëria "Projeksion Energji" sh.a. është pajisur me licencën për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Rehovë", HEC "Treskë 1" dhe HEC "Çarshovë", me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 15, datë 27.08.2003, të ndryshuar me vendimin nr. 47, datë 18.04.2008.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3060 prot., datë 13.10.2026, shoqëria "Bogova 2025" sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për ndryshimin e licencës dhe kalimin në emrin e saj të licencës së prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë "Projeksion Energji" sh.a., vetëm për sa i përket HEC "Treskë 1" dhe HEC "Rehovë", të cilat sipas kontratave respektive për shitje të pasurisë së paluajtshme të datës 03.12.2025 kanë kaluar në pronësinë e saj. Nga ekstrakti historik i regjistrit tregtar rezulton se shoqëria "Projeksion Energji" sh.a. është në statusin "në likuidim e sipër" dhe në këto kontrata shoqëria është përfaqësuar nga likuidatorja e caktuar me vendimin përkatës të gjykatës.
- Ndërkohë, lidhur me HEC "Çarshovë", në ERE është administruar korrespondenca e Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë (MIE), konkretisht shkresa nr. 4272/1 prot., datë 30.07.2015, drejtuar shoqërisë "Projeksion Energji" sh.a., lidhur me të drejtat e kësaj shoqërie mbi HEC "Çarshovë", si dhe shkresa nr. 6411/1 prot., datë 01.11.2016, drejtuar shoqërisë

"KENXHI" sh.p.k., ku përcaktohet se rikonstruksioni i këtij HEC-i është objekt i veprimtarisë së kësaj shoqërie.

- Gjithashtu, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2938 prot., datë 27.11.2025, MIE ka njoftuar për informacionin e paraqitur nga shoqëria "KENXHI" sh.p.k. mbi fillimin e punimeve për rikonstruksionin e këtij HEC-i.
- Për sa më sipër, duke qenë se të treja veprat hidroenergjetike, HEC "Treskë 1", HEC "Rehovë" dhe HEC "Çarshovë", rezultojnë të jenë tjetërsuar dhe shoqëria "Projeksion Energji" sh.a. nuk zotëron më të drejta pronësie apo të drejta përdorimi mbi to, vlerësohet se nuk ekziston më baza faktike dhe juridike për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së licencuar nga kjo shoqëri.

3. Nevoja për rishikimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"* parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet/shfuqizohet nga organi kompetent me një akt të ri me shkrim. Në mbështetje të nenit 113 të ketij ligji, bordi i ERE-s, si organi kompetent për licencimin në sektorin e energjisë elektrike, mund të shqyrtojë shfuqizimin e vendimeve të mëparshme të licencimit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Në rastin konkret, duke qenë se nga dokumentacioni i administruar rezulton se hidrocentralet "Rehovë", "Treskë 1" dhe "Çarshovë" kanë kaluar në pronësi të subjekteve të tjera, vlerësohet se, nëse konfirmohet mungesa e të drejtave të shoqërisë "Projeksion Energji" mbi këto asete, nuk ekzistojnë më kushtet për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së licencuar. Për rrjedhojë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 59/2026 që rregullojnë heqjen e licencave dhe me Kodin e Procedurave Administrative, vlerësohet i shfuqizimi, me efekte për të ardhmen, i vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 15, datë 27.08.2003, të ndryshuar.
- Me hyrjen në fuqi të shfuqizimit si më sipër, licenca e dhënë me vendimin e bordit të Komisionerëve nr. 15, datë 27.08.2003, e ndryshuar, dhe çdo akt tjetër i dalë në zbatim të saj bëhen të pavlefshme.
- Kërkesa e shoqërisë "Bogova 2025" sh.p.k. do të ndiqet më vete, sipas përcaktimeve dhe afateve ligjore.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë me efekte juridike për të ardhmen, vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 15, datë 27.08.2003, të ndryshuar me vendimin nr. 47, datë 18.04.2008, për dhënien e licencës së shoqërisë "Projeksion Energji" sh.a. për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Rehovë", HEC "Treska 1", dhe HEC "Çarshovë".

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e dhënë me vendimin e bordit të komisionerëve nr. 15, datë 27.07.2003, e ndryshuar, dhe çdo akt tjetër i dalë në zbatim të tij përfundon së prodhuari efekte juridike.

3. Shfuqizimi i vendimit sipas pikës 1 të këtij vendimi nuk sjell kalimin e licencës te subjektet që kanë fituar të drejta mbi hidrocentralet përkatëse. Kërkesat e këtyre subjekteve për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike do të shqyrtohen nga ERE në procedura të veçanta, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "Projeksion Energji" sh.a., likuidatoren e shoqërisë "Projeksion Energji" Znj. Adriana Kalaja, shoqërinë "Bogova 2025" sh.p.k., shoqërinë "KENXHI" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a., si dhe shoqërinë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI